




Të shtëna armësh në aheng, policia arreston një 63-vjeçar në Gjilan

KRONIKA | July 25, 2022 - 09:57

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Një 63-vjeçar është arrestuar të dielën në Gjilan, nën dyshimin se ka përdorur armën në një aheng.

Policia ka njoftuar se të dielën ka pranuar një informatë se në Gjilan, rruga e Prishtinës, janë dëgjuar të shtëna me armë zjarri, ku më pas patrulla policore ka arritur të lokalizojë vendin e ngjarjes, ku ka takuar të dyshuarin E.I.

Në vendin e ngjarjes policia ka gjetur prova materiale se i dyshuari gjatë një ahengu familjar ka shtënë disa herë me armë zjarri.


“Arma e llojit ‘Below TR17’, së bashku me gëzhojat e armës përkatëse, janë konfiskuar si dëshmi materiale për Gjykatë. I dyshuari është arrestuar nga Policia e Kosovës dhe është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës.

Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar që i dyshuari të ndalet në mbajtje për 48 orë, ndërsa rasti me kallëzim penal për veprat penale ‘Armëmbajtje pa leje’, ‘Përdorim i armës ose mjetit të rrezikshëm’ dhe ‘Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm’, të procedohet së bashku me provat në Prokurorinë Themelore në Gjilan”, thuhet në njoftimin e Policisë. /Zëri




Arma e sekuestruar

Të rekomanduara



Të shtëna armësh në aheng, policia arreston...

July 25, 2022



Hajnat i vjedhin gjëra nga vetura një...

July 25, 2022

Babai shqiptar i 10 fëmijëve në Austri tenoti ta vrasë gruan me kablo elektrike

KRONIKA | July 24, 2022

Alarm për bombë në Amfiteatrin e Bibliotekës Universitare në Prishtinë

KRONIKA | July 24, 2022

Shoferi i dehur shkakton aksident në Zubin Potok, vdes një 23-vjeçar

KRONIKA | July 24, 2022

Alarm i rremë për bombë në Universitetin e Prishtinës

KRONIKA | July 24, 2022

Policia sllovene: 27-vjeçari nga Kosova u mbyt në liqen, s'bëhet fjalë për krim

KRONIKA | July 24, 2022

Arrestohet një person në Vushtri për zjarrvënje të qëllimshme

KRONIKA | July 21, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | July 24, 2022

Publikohet fotografia e mërgimtarit që u vra në Skenderaj



KRONIKA | July 23, 2022

Arrestohet ferizajasi që mbajti tri ditë të mbyllur të dashurën, e rrahu dhe e bëri për spital



KRONIKA | July 23, 2022

Një i vrarë dhe dy të plagosur në Baks të Skenderajt



KRONIKA | July 23, 2022

Gjendet i vdekur një person në Prishtinë



KRONIKA | July 23, 2022

Policia jep më shumë detaje rreth vrasjes në Baks të Skenderajt



KRONIKA | July 24, 2022

Babai shqiptar i 10 fëmijëve në Austri, tenoti ta vrasë gruan me kablo elektrike